REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

Nr 7494/1 Prot

Elbasan më 15.01.2024

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Qendra Faktoje

Në përgjigje të kërkesës suaj, datë 11.1.2024, ju bëjmë me dije se Bashkia Elbasan prej 5 vitesh tashmë ka organizuar çdo vit Buxhetimin me Pjesëmarrje, me qëllimin për ti dhënë zë dhe të adresojë çdo çështje që lidhet me komunitetin duke siguruar përgatitjen e një buxheti i cili paraqet prioritetet dhe nevojat e qytetarëve.

Konsultimi i buxhetit vjetor të vitit 2023 është zhvilluar në Nëntor 2022 ndërsa i buxhetit të vitit 2024 në Nëntor të vitit 2023 përkatësisht në 6 rajonet dhe 12 njësitë administrative të Bashkisë Elbasan. Njoftimet janë bërë publike në faqen e ineternetit të Bashkisë dhe në rrjete sociale, si platforma lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët dhe çdo grup interesi, bashkangjitur gjeni linkun e njoftimit:

- Njoftimi: https://elbasani.gov.al/kalendari-buxhetim-me- pjesemarrje/

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni proçesverbalet e konsultimeve lidhur me buxhetin e vitit 2024, si dhe rekomandimet.

Gjatë takimeve me banorët lidhur me buxhetin e vitit 2024, në çdo rajon dhe njësi administrative, është konsultuar dhe janë informuar banorët për ndryshimet përkatëse në paketën fiskale për vitin 2024. Gjithashtu është organizuar një dëgjesë publike, në ambjentet e Bashkisë Elbasan duke përfshirë grupe interesi, kryesisht nga fusha e biznesit si target grup i cili preket më tepër nga ndryshimet e taksave dhe tarifave, takim i organizuar më datë 13.11.2023. Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni proçesverbalin e këtij takimi.

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 18, Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak ka organizuar disa konsultime publike lidhur me tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023. Njoftimet për këto takime janë bërë publike në faqen e internetit të bashkisë në linkun si më poshtë:

- https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik/
- https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik-2/
- https://elbasani.gov.al/njoftim-per-konsultim-publik-date-23-10-2023/
- https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik/

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni proçesverbalet e takimeve.

Çdo mbledhje e Këshillit Bashkiak dhe të Komisioneve të Këshillit, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", Neni 53, ka publikuar njoftimin për mbledhjen e tij i cili përmban datën, orën vendin dhe rendin e ditës në faqen e internetit të bashkisë, në rrjete sociale dhe tek stenda e informimit në ambjentet e bashkisë. Bashkangjitur gjeni linkun e njoftimeve dhe të proçesverbaleve të mbledhjeve:

- Njoftimet: https://elbasani.gov.al/keshilli/media-lajme/njoftime-mbi-mbledhjen-e-keshillit/
- Proçesverbale: https://elbasani.gov.al/keshilli/procesverbale-te-mbledhjeve/

Nisur nga sa më sipër Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak bazuar në aktet ligjore përkatëse ka publikuar në faqen e internetit të bashksë çdo njoftim lidhur me organizimin e dëgjesave publike duke respektuar afatet ligjore të tyre si më poshtë:

- https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik-5/
- https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik-4/
- https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik-3/
- https://elbasani.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-me-publikun/

Lidhur me fondin social Bashkia Elbasan ka qënë përfituese prej disa vitesh në disa projekte të tilë si ngritja e qëndrës multifunksionale në Shushicë në bashkëpunim me Terre des homes duke nisur nga 2020 me kohëzgjatje 3 vjet, njësia lëvizëse në njësitë administrative që nga viti 2020, projekti lidhur me ofrimin e shërbimit në familje për fëmijët me aftësi të kuzifuar, projekt i cili nuk zgjati gjatë pasi implementimi i tij përkoi me pandeminë në vitin 2019.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**ZV/ KRYETARE**

**Aulona Bylykbashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan", Tel +355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

•

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# Proçes-verbal

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Lagjja Nr.1

**Data** :07.11.2023

**Vendi:** Pranë shkollës Luigj Gurakuqi

**Numri i pjesëmarrësve**: 256 pjesëmarrës,1 69 burra dhe 87 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Lagjjes Nr.1, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Lagjjes, u renditën këto prioritete:

- Rikonstruksion i shkollës Luigj Gurakuqi.
- Asfaltim tek rruga Refik Serica. Lagja Beqir Dardha
- Asfaltim tek rruga Halit Narazani. Lagja Emin Matraxhiu
- Asfaltim tek rruga Ferdinand Paparisto. Lagja Emin Matraxhiu
- Rikonstruksion i Markatës Ushqimore. Lagja Kongresi Elbasanit
- Vendosja e ndricuesve.
- Shtim i hapësirave të gjelbërta.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

# Proçes-verbal

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Lagjja Nr.2

**Data** :09.11.2023

**Vendi:** Pranë shkollës Ali Agjah

**Numri i pjesëmarrësve**: 109 pjesëmarrës, 66 burra dhe 43 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Lagjjes Nr.2, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Lagjjes, u renditën këto prioritete:

- Asfaltim, rruga Grigoris Perikli Lagja Shënkoll.
- Asfaltim, rruga Hasan Bajraktari Lagja Shënkoll.
- Asfaltim, rruga Petraq Popa (rruga e ujësjellësit).
- Asfaltim, Rrruga Ismail Qemali lagja Çlirimi.
- Ngrohje dhe cerdhe.
- Shtimi i aktivitetve kulturore.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Lagjja Nr.3

**Data** :09.11.2023

**Vendi:** Pranë shkollës Jorgji Dilo

**Numri i pjesëmarrësve**: 115pjesëmarrës, 68 burra dhe 47 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Lagjjes Nr.3, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Lagjjes, u renditën këto prioritete:

- Asfaltim dhe KUZ tek rruga Tajar Tetova.
- Rikonstruksion i shkollës Sul Misiri.
- Sistemim rruge që lidh Katundin e ri me lagjen Skëndërbej.
- Sistemimi me KUZ i rrugës Qamil Shkodra lagja "Skëndërbej".
- Shtim i sipërfaqeve të gjelbërta.
- Shtim i aktiviteteve kulturore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Lagjja Nr.4

**Data** :09.11.2023

**Vendi:** Pranë shkollës Bardhyl Popa.

**Numri i pjesëmarrësve**: 123 pjesëmarrës, 71 burra dhe 52 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Lagjjes Nr.6, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Lagjjes, u renditën këto prioritete:

- Sistemim i rrugës veriore në lagjen ''Kala''
- Rikonstruksion i rrugës ''Jani Todri''
- Restaurim i qendrës së këshillimit të karrierës
- Restaurim i shtëpisë së Aleksandër Xhuvanit
- Rikonstruksion i shkollës Fejzulla Guranjaku.
- Kërrkesë për ndriçues
- Shtim i sipërfaqeve të gjelbra

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Lagjja Nr.5

**Data** :08.11.2023

**Vendi:** Pranë konviktit të vajzave.

**Numri i pjesëmarrësve**: 103pjesëmarrës, 56 burra dhe 47gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Lagjjes Nr.5, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Lagjjes, u renditën këto prioritete:

- Rivitalizim i shehseve tw pallateve nw lgj 5Maj
- Shtim i aktiviteteve kulturore.
- Rikonstruksion i rrugës "Agim Hasekiu" (asfalt, ose pllaka)
- Sistemim, asfaltim i rrugës " Qamil haxhifejzo",
- Rikonstruksion i rrugës "Josif Gjini"
- Rikonstruksion i rrugës " Shazivar Bej Karaosmani".

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Lagjja Nr.6

**Data** :08.11.2023

**Vendi:** Pranë shkollës Imelda Lambertini.

**Numri i pjesëmarrësve**: 114 pjesëmarrës, 61 burra dhe 53 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Lagjjes Nr.6, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Lagjjes, u renditën këto prioritete:

- Rivitalizim i shehseve të pallateve në lgj 5Maj
- Shtim i aktiviteteve kulturore.
- KUZ dhe mirëmbajtje rrugësh.
- Sistemin i sheshit tek pallatet në rrugën Aleks Buda përfshirë dhe rrugën Selim Zyma.
- Asfaltim, rruga Josif Papamihali.
- Asfaltim, rruga Peter Dodbiba.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KESHILLI BASHKIAK.**

## Proçes-verbal

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Bradashesh dhe Gracen.

**Data** :09.11.2023

**Vendi:** Pranë Njësisë Administrative Bradashesh

**Numri i pjesëmarrësve**: 52pjesëmarrës, 41 burra dhe 11 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Bradashesh dhe Gracen, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Bradashesh dhe Gracen, u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët e Bradasheshit janë:**

- Ndricues rrugësh.
- Shtrimi i rrugës në fshatin Gurabardh ne një gjatësi 1.5 km
- Venshje me beton KU.
- Shtrim i rrugëve lidhëse për dalje në autostrate.

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët e Gracenit janë:**

- 1 km asfaltim në Gracen qendër dhe Gracen fshat.
- Asfaltim për rrugën Dopaj- Shëngjin- Gjorme.
- Sistemimi i përroi nga xhamia 500m. deri tek varrezat e fshatit. Tërbac
- Ndricues rrugësh.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# Proçes-verbal

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Gjergjan.

**Data** :08.11.2023

**Vendi:** Pranë njësisë administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 87 pjesëmarrës, 56 burra dhe 31 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Gjergjan, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Gjergjan, u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë:**

- Asfaltim i rrugës së qendrës që lidhet me rrugën e varrezave. Muriqan
- Shtrimi i rrugës nga shkolla deri deri tek lagja e Zylajve. Gjonme
- Rikonstruksion i shkollës. Thanë
- Riparim i kanaleve kulluese dhe vaditëse. Thanë
- Asfaltim dhe KUZ tek lagja Qyra, lagja e Xhamisë tek rruga Licajve. Gjergjan

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Labinot Mal

**Data** :10.11.2023

**Vendi:** Pranë njësisë administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 91 pjesëmarrës, 70 burra dhe 21 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Gjergjan, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Labinot Mal u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë:**

- Asfaltimi i rrugës Xibrakë-Lugaxhi.
- Asfaltim i rrugës Guri Zi-Qafe Renas-Benë, riveshje me asfalt 3 km.
- Rikonstruksion i ujësjellësit lagja Katund dhe Qerret.
- Rikonstruksion i rrugës së Kronës, Lamollë.
- Ndërtimi i rrjetit elektrik me kabëll ABC në fshatrat që nuk u përfshinë në projektin e parë si Lamollë, Lugaxhi, Benë dhe pjesërisht disa fshatra të tjerë.
- Mirëmbajtje kanalesh ujitëse dhe vaditëse

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Gjinar.

**Data** :07.11.2023

**Vendi:** Pranë njësisë administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 75 pjesëmarrës, 52 burra dhe 23 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Gjergjan, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Gjinar u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë:**

- Rivitalizimi i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqës.
- Rikonstruksion i rrugës Valesh 200-300 m tek kthesa. Valesh
- Zhavorim afër kalasë Valesh.
- Ndërtim rrjeti KUZ. Lleshan
- Vendosja e ndricuesvë.
- Zhavorim dhe KUZ për rrugën e fshatit. Lukan

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

# Proçes-verbal

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Tregan.

**Data** :08.11.2023

**Vendi:** Pranë Njësisë Administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 102 pjesëmarrës, 65 burra dhe 37 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Tregan, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Tregan, u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë:**

- Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Tregan Jonuz Carciu.
- Asfaltim i rrugës së varrezave Llixhë – Qendër.
- Shtrim i rrugës kryesore në fshatin Kycyk.
- Vendosja e ndricuesve, stolave dhe koshave në Tregan.
- KUZ ne fshatin Mucan.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Shushicë.

**Data** : 07.11.2023

**Vendi:** Pranë Njësisë Administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 89 pjesëmarrës, 64 burra dhe 25 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Shushicë, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Shushicë, u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë:**

- Asfaltimi i rrugës Baltavere.Shushicë
- Mirëmbajtje rrugësh.
- Betonim i kanalit vaditës Gurakuqi. Shushicë
- Shtrim i rrugës së varrezave Shelcan
- Asfaltim i rrugës tek Unaza Bujqësore 500km. Vreshaj
- Asfaltim i një sgmenti rruge. Hajdaran
- Asfaltim i rrugës së fshatit Polis Valë
- Veshje me beton tek lagja e Rudajve.
- Rikonstruksion i urës mbi përroin e Gostimës.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Shirgjan.

**Data** :08.11.2023

**Vendi:** Pranë Njësisë Administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 84 pjesëmarrës, 46 burra dhe 38 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Shirgjan, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Shirgjan, u renditën këto prioritete:

**Prioritet më të votuara nga vete banorët e njesisë jane :**

- Asfaltim rruge tek lagja Bërzheshtës dhe e Cekrezëve 400m. Bathës
- Asfaltim tek unaza e fshatit tek unaza fshatit në lagjen e Cakallëve. Kryezjarr
- Sinjalistika rrugore.
- Veshje me beton KU.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

## Proçes-verbal

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Papër.

**Data** :16.11.2023

**Vendi:** Pranë Njësisë Administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 95 pjesëmarrës, 63 burra dhe 32 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Papër, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Papër, u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë:**

- Shtrim i rrugës në lagjen e sipërme për rrugën Broshkë- Valas.
- Asfaltim i rrugë Papër- Pajun.
- Rikonstruksioni i dy urave. Papër Sallak
- Prita lumore. Papër Sallak
- Veshje KU në aksin Balldren- Vidhas- Papër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**Proçes-verbal**

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Funar.

**Data** :09.11.2023

**Vendi:** Pranë Njësisë Administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 115 pjesëmarrës, 82 burra dhe 33 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Funar, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Funar, u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë**:

- Pastrimi i përroit të Kushës. Branash
- Pastrim i rrugës neë lagjen Hanol. Cerujë
- Pastrim rrugësh. Krrabë e Vogël.
- Mirëmbajtje rrugësh.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# Proçes-verbal

**Konsultim publik** : Buxhetimi me pjesëmarrje 2023, Njësia Administrative Labinot Fushë

**Data** :10.11.2023

**Vendi:** Pranë njësisë administrative

**Numri i pjesëmarrësve**: 87 pjesëmarrës, 54 burra dhe 23 gra.

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Takime Konsultuese me banorët e Njësisë Administrative Gjergjan, mbi planifikimin e investimeve të buxhetit 2024. Pas votimit të bërë nga vetë banorët e Njësisë Administrative Labinot Fushë u renditën këto prioritete:

**Prioritetet më të votuara nga vetë banorët janë:**

- Riparim rema e qytetit tek pjesa e dëmtuar Sifoni Gurra.
- Ndërtim muri pritës tek Gurra.
- Kalimi i puseve tek ujësjellësi bashkisë në Godolesh poshtë.
- Asfaltimi i rrugës që lidh Shegunës poshtë dhe Godolesh sipër 1km rrugë poshtë mbi 3km rrugë lartë.

PROÇESVERBAL

Proçesverbal i konsultimit publik me bizneset për taksat dhe tarifat vendore, i mbajtur më datë 13.11.2023 ora 10:30 në sallën e mbledhjeve të Bashkisë Elbasan, ku marrin pjesë kryetari i bashkisë Z. Gledian Llatja, Zv. Kryetare e bashkisë Anj. Aulona Bylykbashi, Drejtori i përgjithshëm Z. Qemal Tusha, Drejtor i Taksave Z. Klevis Cullhaj, qytetarë, sipërmarrës dhe anëtarë të këshillit bashkiak.

**Z. Klevis Cullhaj**:

Faleminderit që iu përgjigjët ftesës sonë për të qënë pjesë e këtij konsultimi publik. Ne si bashki jemi duke rishikuar disa gjëra, jo për të pasur tarifat më të larta, por për të bërë një rritje të cilën fillimisht do ta bisedojmë bashkë.

**Z. Gledian Llatja**:

Ne ju quajmë bazën tonë ekonomike. Do të ishtë pa kupim mos ta fillonim bashkë buxhetimin e target grupeve. Kemi disa probleme sociale por këto katër vite kemi bërë disa punë dhe po përgatitemi për programin tjetër. Kur i themi qytetarëve për paketën fiskale kanë më pak interes sesa ju. Jemi në trend për shumë biznese që e shohin Elbasanin si potencial lidhur me infrastrukturën. Edhe ne si bashki jemi përpjekur të bëjmë më të mirën. Po mundohemi të bëjmë shumë projekte për zhvillimin e qytetit siç është bypass i Elbasanit, project i cili nuk i shërben vetëm Elbasanit po të gjithëve. Shpresoj që vitin tjetër ti kemi të hapura kantierët e punimeve për bypassin.

Këto janë disa nga prioritetet tona, ku gjithashtu përfshihet Gjinari dhe Funari. Kemi mbyllur pothuajse problematikat me energjinë, me ujin e pijshëm, por kemi akoma probleme me azhornimin e tokave. Këto janë potencialet tona për zhvilolim dhe projektet e mëdha për të pasur një rritje të zhvilimit të Elbasanit. Kemi edhe kalanë të cilën duam ta bëjmë një zonë të lirë ekonomike, ku për bizneset nën $40m^2$ të mos ketë taksa vendore.

Rritja do të bëhet me 25% për gjelbërimin, ndriçimin dhe pastrimin, me qëllimin që të arrijmë tek llogjjika që tarifa mbulon shërbimin. Një qytetari do ti rritet afërsisht 60 lekë të reja në muaj. Gjithashtu po mendojmë të vendosim një tarifë për makinat e vjetra që futen në qytet, për të mbrojtur ajrin.

**Znj. Aulona Bylykbashi**: Është menduar të mos ketë asnjë rritje në taksën e ndërtesës. Rritjet do të jenë për tarifat e ndriçimit, pastrimit dhe gjelbërimit me 25%. Me këtë rritje do të lehtësohet bashkia me 20%. Për të treja këto tarifa familjet do të paguajnë 69 lekë më tepër në muaj, biznesi i vogël 254 lekë më tepër, biznesi i vogël me TVSH 540 lekët më tepër.

**Z. Gledian Llatja**: Taksën e ndërtesës, infrastrukturës i kemi lënë në minimumin ligjor. Kemi bërë rritjen e tarifave për shtimin e investimeve.

Po mendojmë një model të ri subvencionesh për hapjen e bujtinave në Gjinar, ose kush kërkon të kthejë shtëpinë e tij në bujtinë do të japim subvencion për rregullimin e kuzhinës dhe tualetit të cilat janë kryesoret për shërbimin. Ka shumë potencial turistik dhe ka disa modele të tilla në Gjinar dhe në Funar. Të njëjtën gjë mendojmë edhe më rehabiliminin e fasadave të shtëpive tek porta e kalasë.

**Qytetarë**: Unë në Gjinar kam një objekt. Duhet të marr leje nga AZHBR për ndërtime?

Për ta kthyer në bujtinë duhet marrë leje tek AZHBR, ndërsa për leje për rikonstruksion duhet ta merrni tek ne.

**Qytetarë**: Kemi një biznes transport udhëtarësh, por janë dhe dy taksi që punojnë në Dopaj. Punojmë të dy dhe në këtë mënyrë nuk justifikohet tregu me taksitë. Nuk e di nëse janë të rregjistruar por nëse po ne me autobuza nuk mund të punojmë dot. Po ashtu kemi problem me ndalesat në autostradë. Janë pika ku marrim nxënësit për në shkollë, e vetmja mënyrë për ti marrë, por në ato ndalesa marrim gjobë. Dhe një problem tjetër është prishja e rrugës tek xhamia në Dopaj, është e pakalueshme nuk mund të punojmë.

**Z. Gledian Llatja**: Pas ndarjes së punëve publike të qytetit dhe fshatit besoj se do ta gjejmë një zgjidhje.

**Qytetarë**: Jam banorë i fshatit Hajdaran, kam një dyqan mishi dhe kemi probleme me ujin e pijshëm.

**Z. Gledian Llatja**: Po e dimë si problem, po presim të bëjmë një investim për të gjithë rrjetin e fshatit atje.

Mbajtëse e proçesverbalit

Livia Guri

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

Nr 4269 Prot

Elbasan më 28.08.2023

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli**: "Konsultim me bashkësinë Për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë.

**Propozuesi**: Kryetari i Këshillit Bashkiak.

**Qëllimi**: Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimmarrje lidhur me një pikë të rendit të ditës së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak Elbasan.

**Sqarime**: Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi miratimin e disa vendimeve që kërkojnë konsultim më bashkësinë bazur në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 18 dhe Neni 54.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet më datë 04.09.2023 ora 09:00 në Njësinë Administrative Labinot Fushë.

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Kryetar i Këshillit Bashkiak,
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Elbasan, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

| | |
|---|---|
| Qëllimi i këshillimit publik | Konsultimi publik në terren synon për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve lidhur me vendimarrjen e Këshillit Bashkiak Elbasan. |
| Përshkrimi i çështjes. | 1. Për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë.<br>Në gjendje te keqe |

| | |
|---|---|
| | vegjetative me kurorë dendësinë nën 0.5. janë në zona të pazhvilluara nga ana sociale rreth 1.5 km larg zonave të banuara dhe 600 metra mbi nivelin e detit.<br>Në këto kushtë, përderisa në këto sipërfaqe nuk ka studime dhe plane zhvillimi për këto territore, si dhe investime tjera afatgjata, propozohet dhënia në përdorim të tokës pyjore me një afat 10 vjeçar.<br>Në zbatim të dispozitave ligjore Ligjit nr. 8318, datë 1.04.1998 "Për dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar (neni 13 dhe 16), ligjit nr.57/2020 "Për pyjet", Udhëzimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.1, dt.9.6.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqrtimit dhe të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", si dhe akteve tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe duke parë emergjencën dhe krizën globale për burime energjitike. |
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve | Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në ditën e mbajtjes së takimit. |
| Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme | Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit:<br>Ndryshime dhe/ose alternativat e mundshme në zgjedhjen e komisioneve të këshillit. |
| Dokumentacioni, në lidhje me çështjen që konsultohet. | Bashkangjitur këtij njoftimi projektvendimet që do të shqyrtohen në konsultimin publik. |

KRYETARI

LUTFI LALA

PROÇESVERBAL

Procesverbal i mbajtur me datë 28.09.2023 ora 09:05, në ambjetet e shkollës Luigj Gurakuqi, për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për vendosje stacionesh, bazamete për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë. Marrin pjesë grupe të interest, këshilltarë, Drejtori Drejtoria e administrimit të pyjeve dhe kullotave.

**Shpëtim Cullhaj - Drejtori Drejtoria e administrimit të pyjeve dhe kullotave:**

Jemi për një konsultim me grupet e interesit. Duam mendimin tuaj për vendosjen e këtyre paneleve. Nuk janë vende të pyllëzuara, është formacion shkëmbor. Këtu kemi përfaqësues nga biznesi dhe shoqata. Mehmetaj kryetar i klubit ekologjik, Xhaferr Duraku përfaqësues i komunitetit Labinot Mal, biznesmen të kësaj zone, Astriti merret me tregtinë e luleve, Indriti anëtar i KB dhe kryetar komisioni për pyjet i cili ka interest të mos dëmtohet dhe mbrohet mjedisi. Luan Rama, Sokol Sinani përfaqësues për të mbrojtur interesat e komunitetit.

**Ahmeti:**

Bëhet fjalë përprodhimin e energjisë më diell. Sipërfaqa 90ha do të shtrihet në territore që nuk kanë bimësi, investmi I shërben endit dhe të ardhmes, shërben si eksperiment për të kuptuar nëse do të ishte mirë siç është apo të kthehet në prodhim energjie. Një aspect tjetër është që rrit anën ekonomike. Është përveojë e parë, do të bëhet eksperiment i ri për zhvillim.

**Refik Hoxha:**

Janë bashkëpunime të mira. Duhet parë terreni, të bëhet vizitë në terren kur kemi raste të tilla.

**Astrit Elezi**: Përfiton biznesi. I njoh shumë mirë pyjet. Çfarë ka mudësi të shfrytëzohet për komunitetin ose jo.

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

Nr 4349 Prot

Elbasan më 1 .09.2023

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli**: "Konsultim me bashkësinë Për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë.

**Propozuesi**: Kryetari i Këshillit Bashkiak.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimmarrje lidhur me një pikë të rendit të ditës së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak Elbasan.

**Sqarime**: Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi miratimin e disa vendimeve që kërkojnë konsultim më bashkësinë bazur në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 18 dhe Neni 54.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet më datë 11.09.2023 ora 09:00 në Njësinë Administrative Labinot Fushë.

Pjesëmarrës:
- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Kryetar i Këshillit Bashkiak,
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Elbasan, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

| | |
|---|---|
| Qëllimi i këshillimit publik | Konsultimi publik në terren synon për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve lidhur me vendimarrjen e Këshillit Bashkiak Elbasan. |
| Përshkrimi i çështjes. | 1. Për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë. |

| | |
|---|---|
| | Në zbatim të dispozitave ligjore Ligjit nr. 8318, datë 1.04.1998 "Për dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar (neni 13 dhe 16), ligjit nr.57/2020 "Për pyjet", Udhëzimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.1, dt.9.6.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqrtimit dhe të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", si dhe akteve tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe duke parë emergjencën dhe krizën globale për burime energjitike. |
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve | Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në ditën e mbajtjes së takimit. |
| Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme | Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit: Ndryshime dhe/ose alternativat e mundshme në zgjedhjen e komisioneve të këshillit. |
| Dokumentacioni, në lidhje me çështjen që konsultohet. | Bashkangjitur këtij njoftimi projektvendimet që do të shqyrtohen në konsultimin publik. |

KRYETARI

LUTFI LALA

Adresa: Bashkia Elbasan", Tel +355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

PROÇESVERBAL

I mbajtur më datë 11.09.2023, ora 09:15 në ambjentet e njësisë administrative Labinot Fushë ku zhvillohet konsultim publik "Për dhënien e fondit pyjor në përdorim për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë."

Marrin pjesë anëtarë të Këshillit Bashkiak Elbasan, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni, Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, banorë të zonës, specialist, media dhe qytetarë.

**Z. Lutfi Lala Kryetar i KB:**

Organizohet seancë e dhënies së një pjese trualli për panele diellore. Fond pyjor për dhënie panelesh voltaikë. Zona Griqan 33ha. Në bazë të këshilliot bëjmë seancë këshillimi me banorët e zonës. Hapet konkurimi në treg.

**Z. Shpëtim Cullhaj-Drejtori, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:**

Ne si drejtori kemi propozuar për dhënie në përdorim të fondit pyjor për vendosjen e paneleve fotovoltaike. Është pjesa në afërsi të Labinot Katund pjesa që rrjedhin ujërat nga rruga nacionale. Aty është propozuar një sipërfaqe prej 45 ha ndërsa sipërfaqa tjetër është në Griqan e Sipërm. Qëllimi i këtij propozimi është për të vendosur panele fotovoltaike duke qënë se panelet fotovoltaike janë burim i pastër energjie nuk ka ndotje duke marrë shkas edhe nga ngarkesa energjitike dhe në bazë të ligjit të Këshillit që u fut në votim në Këshill Bashkiak. Kjo është seancë këshilluese dhe konsultuese. Nëse do të keni ndonjë pyetje konkrete, kjo është në të mirë të bashkisë. Pas miratimit Këshilli do të hap proçedurën për ta vënë në përdorim dhe do të hap proçedurat konkuruese.

**Banorë**: Kush është përfituesi?

**Z. Lutfi Lala Kryetar i KB**:

Nuk bëhet fjalë konkretisht, në Griqan tek shkëmbi. Nuk ka banesa.

**Qani Xhafa**:

Do të doja të bëhej një bisedim edhe me banorët e fshatit Labinot-Katund. Rekomandim nëse mblidhet Këshilli Bashkiak.

**Z. Lutfi Lala Kryetar i KB**: Nuk janë në dëm të askujt.

**Banorë**: Rrezatimi i paneleve është i rrezikshëm. Janë pranë qendrave të banuara.

**Banorë**: Çfarë përfiton komuniteti me këtë? Kush janë banorët e këtyre zonave që preken?

**Agim Sula**: Pse të mos bëhet në zona të tjera?

**Fatmir Bica**: Mos të bëhet në zona të banuara, pra jashtë zonave të banuara.

**Banorë:** Në atë zonë merren dru për dimër, ka tufa bagëtish që kullosin, nuk ka ku të çojmë bagëtitë, e dyta me ndryshimet klimatike ta shpyllëzosh pyllin do të ketë përmbytje. U mbyll kanali vaditës pasi shi të bie përmbytet.

**Doris Madhi anëtare e Këshillit Bashkiak**: Duhet shprehur ka kaq shpenzime, ka kaq të ardhura që shkojnë në favour të X, Y, Z. Kështu bëhet studimi. Prezantojeni komunitetit.

**Z. Lutfi Lala**: Duhet thënë se sa shkon investimi.

**Doris Madhi anëtare e Këshillit Bashkiak**:

Patjetër. A ke ardhur ti të dëgjosh. Z.Kryetar në rradhë të parë banorët nuk po saktësohen për zonën sepse me shumë të drejtë ngrenë një shqetësim sepse ti po thua çfarë pyetje bëjnë. Pyetja parë që po bëjnë është kush janë banorët e asaj zone me emra sepse nuk jetojnë 1 miljon vet atje, kush janë banorët që preken. Nëse ju keni bërë një studim zone, duhet të dini kush janë familjet që preken, nëse ka mbivendosje apo jo, nëse ka zona të shfrytëzuara nga këto banorë, nëse këto zona shfrytëzohen në pronësi apo përdorim. Duhet ti dini dhe duhet tia thoni banorëve, sepse ato banorë duhet të ishin këtu sot, por ato nuk janë pasi nuk janë lajmëruar.

**Banorë**: Këtë fshat e keni rrethu në çdo anë. Panelet diellore kaq afër zonave të banimit kanë rrezatim shumë të madh. Çfarë do të ndodhi me këto familje. Ne kemi 30 vjet që nuk është zgjidh e drejta jonë, e drejta e pronës. Pa u mbyll një problem hapet problem tjetër.

**Banorë**: Duhet shqyrtuar vendi i saktë, duhen foto dixhitale, jo foto google, duhet ta shohim kush preket, kush cënohet. Nuk ka kopësht, qëndër shëndetësore.

**Altin Meçja**: Duhet një publik edhe më i gjerë, dhe unë kam një sygjerim që këto dëgjesat ti bëjmë masdite. Ju keni punë me tre fshatrat jo vetëm këtu.

**Z. Lutfi Lala Kryetar i KB**:

Nuk duam ti bëjmë dëm askujt, nuk jam që të shkulim ullinjt. Nëse ne do të vazhdojmë me gjykimin që unë e kam afër shtëpisë them jo. Llogjika është a duam drita, duam, mund ta bëjmë dhe hidroçentralin siç u bë në Fushë Buall.

**Banorë**: Konsultimet janë mirë të bëhen haptazi, jo fshehurazi sepse janë për të mirën e komunitetit dhe Bashkisë Elbasan dhe do të kthehen në investime. Para se ta çoni në Këshill dëgjesa duhet bërë me banorët e Labinot Katund sepse nuk mund të vërë njëri beton atje pa pasur miratimin e banorëve.

Diskutim mbi vendodhjen konkrete të truallit.

Konsultimi mbyllet në 10:30.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e proçesverbalit

Livia Guri

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

Nr 4486 Prot Elbasan më 13.09.2023

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli:** "Konsultim me bashkësinë Për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë.

**Propozuesi:** Kryetari i Këshillit Bashkiak.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimmarrje lidhur me një pikë të rendit të ditës së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak Elbasan.

**Sqarime:** Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi miratimin e disa vendimeve që kërkojnë konsultim më bashkësinë bazur në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" Neni 18 dhe Neni 54.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet më datë 18.09.2023 ora 09:00 në Labinot-Katund.

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Kryetar i Këshillit Bashkiak,
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Elbasan, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

| | |
|---|---|
| Qëllimi i këshillimit publik | Konsultimi publik në terren synon për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve lidhur me vendimarrjen e Këshillit Bashkiak Elbasan. |
| Përshkrimi i çështjes. | 1. Për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë. |

Adresa: Bashkia Elbasan", Tel +355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

PROÇESVERBAL

Proçesverbal i konsultimit publik i mbajtur sot më datë 18.09.2023, ora 09:15 në ambjentet e njësisë administrative Labinot Fushë ku zhvillohet konsultim publik "Për dhënien e fondit pyjor në përdorim për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltanike me qëllim prodhimin e energjisë."

Marrin pjesë banorë të zonës, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni, Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, specialist, media dhe qytetarë të ndryshëm.

**Shpëtim Cullhaj - Drejtori, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**:

I prezanton banorëve projektin, ku për zonën konkrete të Labinot Mal përfshihen 5-10ha. Favoriszon edhe pjesën e infrasturkturës.

**Sadik Sula-banorë:**

Ku do të bëhet konkretisht?

**Shpëtim Cullhaj - Drejtori, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**:

Nuk përfshihen zona të banuara, nuk ka zona të mbjella ullinj, arra. Është pjesë shkurre, tokë gurore sepse këto panele duan diell të shumtë, përfshin më shumë pjesë shkëmbore.

**Islam Hushi-banorë:**

Duam sqarime të qarta për vendin ku është konkretisht, vendi që do të shfrytëzohen këto panele.

**Jonuz Taça-banorë:**

U shpjegon me terma dhe më konkretisht banorëve të zonës duke e ilustruar në hartë, që nuk përfshin zona të banuara, është pjesë shkëmbore dhe përfshin nga shkëmbi poshtë për në Labinot Fushë.

Nuk cënojnë zonat pyjore që përfshihen për dru zjarri, Zoti Rexhep Taça është dakord për këtë projekt por nuk pranon të cënohen zonat pyjore që përfshijnë drut e zjarrit. Të mos cënohen drutë e zjarrit.

**Shpëtim Cullhaj - Drejtori, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**:

Është larg tokave nujqësore, është larg banesave.

Diskutim mbi vendodhjen konkrete të truallit dhe zonat që do të preken nga dhënia në përdorim.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e proçesverbalit

Livia Guri

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

Nr. 5711/1 prot

Dt. 10.10.2023.

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli: "Konsultim për "Propozim për miratimin e shitjes sipas proçedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a "

**Propozuesi**: Kryetari i Këshillit Bashkiak.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimmarrje.

**Sqarime**: Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi miratimin e shitjes sipas proçedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a ".

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me grupet e interesit do të zhvillohet më datë 23.10.2023 ora 13:00 në ambjentet e Pallatit të Sportit Elbasan, ndërsa takimi me qytetarë në datë 23.10.2023 në orën 16:00 në ambjentet e qëndrës Rinore.
Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Kryetar i Këshillit Bashkiak,
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Elbasan, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, grupe interesi.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

| | |
|---|---|
| Qëllimi i këshillimit publik | Konsultimi publik në terren synon për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi mbi miratimin e shitjes sipas proçedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a ". |

| | |
|---|---|
| Përshkrimi i çështjes. | Administratori i Shoqërisë ka kërkuar shitjen e një pjese të aksioneve të shoqërisë. Nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë "Akademia e Futbollit Elbasani" sh.a, është miratuar kërkesa e Administratorit dhe është propozuar fillimi i proçedurave të shitjes së një pjesë të aksioneve të shoqërisë, për të mundësuar afrimin eventualisht të investitorëve të suksesshëm, të cilët mund të paraqesin interes për të qenë pjesë në pronësi të kësaj Shoqërie Aksionere.<br>Një propozim i tillë gjen mbështetje edhe nga Drejtoria e Politikave të Sportit, Rinisë Dhe Aktiviteve , në Bashkinë Elbasan. |
| Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve | Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në ditën e mbajtjes së takimit. |
| Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme | Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit: |
| Dokumentacioni, në lidhje me çështjen që konsultohet. | **Relacion** Nr.___Prot, më ___/___/2023<br>**Propozim për miratimin e shitjes sipas proçedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a** |

KRYETARI

Lutfi LALA

Adresa: Bashkia Elbasan", Tel +355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

Procesverbal datë 25.10.2023

Procesverbal i konsultimit publik i mbajtur sot më 25.10.2023 ora 13:20 për "Propozim për miratimin e shitjes së një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a.

Me pjesëmarrjen e kryetarit të KB. Z. Lutfi Lolo, Z. kryetarit Zamir Rushaj, N/kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, këshilltarë, sportistë, qytetarë etj.

Z. Lutfi Lolo: Ky takim sot është për të miratuar shitjen e disa aksioneve të Sh.a. Elbasan. Duhet të kalojë më konsultim me komunitetin, që për të marrë pjesë në vendimarrje. Do ia jepje fjalën adm

_____ Përshëndetje. Pika kryesore është që është e detyrueshme për të mbuluar shpenzimet

Kush ka ndonjë pyetje

_____: Në parim, këto që do shiten, ne kemi e president, mund të vimë dhe të ...

_____: Pres. vazhdon të jetë bashkia. Duke parë ... x sportin besoj se do të ofrohet.

Shumë kam ...

Z Lutfi: Mora mjaft 70% e aksioneve.

_____: ... një ...

(1)

Elton Gurzenyeku.

Sportist: Pjesë e akademisë e mirë si do behet?

Uniti: Po të ndahet për 30% ti takojë bashkisë, të komandohet një pjesë e drejt. teknike. E kam një eksperiencë që të ngeli një grup e madhe. Kalova. Nas të ngeli

Luan Delia: Është shumë që e mirë që diskutojmë është hero e pare. Pika parë është që u takuam është hero e pare. Pika parë është që u takuam tu ne ka nje. Ky qytet e do futbollin. Bravo për të gjithë ju që e mirëtuat. Është një klub i mesëm. Duhet ndih trajnerësh. Nga gabimet ne mësojmë. Duhet të dime si ta mbështesim. Është një klub i ri. për të historinë futbolli. Ne duhet të bashkohemi të gjithë që dekan ne eke për me mbështetje me një djalë të mirë. Pind i themi ... për 2 vjet një O të kanditosh kenë durim. Për 2 vjet një O të kanditosh x Superligë është punë e madhe. Është oferta shoh si një sky që Elb si ka pas. Është për tu admiruar kur mendojmë që jemi ne kategori të I. Kjo mbështetje isa është në gjendje bashkia me kre pa të mbaj dhe futbolli kur jere 3-4, krijojnë një Shoqe ne në kaga bashkinë. Kontroll që në ener teknike për 30% ta investojë bashkia, ta kontrolloje. Ai kontroll të vlejë më tepër

23.10.23

Konsultim Puplik.

| Emër | Mbiemër | Firmë |
|---|---|---|
| Indrit | ABDIAJ | |
| Mirandi R. | Backa | |
| Arbi | Fetah | |
| Erlind | Çoku | |
| Andit | Çola | |
| Kontriot | Roqi | |
| Arjan | Kila | |
| Juan | Delia | |
| Endri | Duka | |
| GENTIAN | BYLYKBASHI | |
| Ruben | Xhyra | |
| GLERIM | KRRABA | |
| Memo | Dashlu | |
| Dorian | Bylykbashi | |
| Adi | Dosc | |
| Morengle | Çuk | |

# Procesverbal.

Procesverbal i mbajtur më datë 23.10.2023 ora 16:00 në ambjentet e qëndrës rinore mbi "Propozimin për miratimin e shitjes sipas procedurave ligjore të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e futbollit Sh.a., me pjesëmarrjen e qytetarëve, këshilltarëve, Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Auloma Bylykbashi dhe grupe interesi

Z. Lutfi Lala - Kryetari i KB Elbasan:

- Ky takim i organizuar nga KB ka për qëllim konsultimin për një pikë që do të përfshihet në një mbledhje të ardhshme të Këshillit Bashkiak, me aktorë të ndryshëm, u zhvillua edhe tek pallati i sportit, me njerëzit të cilët janë të interesuar në këtë fushë, me mediat me specialist, me biznesmen, ndërsa këtë konsultim aktualisht e zhvillojmë me banorët. KB para se të vendosi për shitjen e disa aksioneve të klubit do të ishte mirë të merrte disa mendime për të ardhur në ndihmë sadopak këtij vendimi. Nga ky moment mund të jepni ndonjë mendim dhe ta diskutoni me përfaqësuesit e tjerë të cilët kanë informacion më shume

dhe kur flasim për asete kemi parasysh edhe një ekip futbolli, nuk i referohemi vetëm objekteve të paluajtshme, i cili është paramar për ta mjerië më shitje 70% të aksiomeve, duke menduar që 30% të aksiomeve ti menaxhoj akoma Bashkia Elbasan për të pasur dhe një lloj kontrolli me ekipin e futbollit dhe me akademinë që dhe qytetarët të jenë më të sigurt që bashkia akoma ka pjesë në menaxhimin e ekipit. Kështu që kjo është ~~një~~ me mënyrë të përmbledhur edhe argumenti ekonomik, edhe argumentin ligjor që na detyrom me bazë të ligjit të sportit. Nëse ju keni ndonjë pyetje për të bërë në lidhje me këtë proces, keni një opinion, ne jemi këtu për të kthyer përgjigje të gjitha pyetjeve që keni.

Qytetare: Do të ishte mirë që ne ti dim këto asete dhe të kuptojmë për çfarë bëhet fjalë. Pak më të qartë, që ne ta kuptojmë më mirë.

Znj. Aulona Bylykbashi: Prandaj jemi që t'ju kthejm përgjigje dhe të jeni të qartë.

Qytetare: E dyta që kam është që të ndërtohet rruga sa më parë tek pallatet tek Lagjja "Hexhias" sepse e kemi shumë problem. Ka ujë shumë.

Znj. Aulona Bylykbashi: Sot do të flasim për sportin. Për kërkesa të tjera e për investime, brenda dy javëve që vjen do shkojmë në çdo lagje për hartimin e buxhetit për vitin 2024, dhe aty

Qytetarë: Nuk mund ta administrojë bashkia të gjithë?

Znj. Aulona Bylykbashi: Nuk është e pamundur por ka kërkesë financiare. Në dy vite ne i kemi dhënë në mini e buxhetit. Sa më shumë rritet ekipi aq më shumë rritet niveli dhe pagesat, shpenzime për transportet, uniformat, fjetje, etj. Janë shpenzime më rritje, në dy vite i kemi dhënë ekipit rreth 350 milion lekë, të cilat po mos t'ia jepnim ekipit do të ishin të përkthyera me investime në rrugë, kështu që duke qenë se është një shoqëri për argëtim, por nuk ka kthim mbrapsh në të ardhura është ngarkesë dhe ndoshta është më mirë ky kombinim për ta menaxhuar me kontroll ekipin.
Ligji i sportit përderisa e ka parashikuar ekzistencën e aksioneve do të thotë që e ngarkon buxhetin e bashkisë.

Qytetarë: Është ekip i ri? Ekipi i parë kështu u privatizua. Mos jemi në rrugën e të parit?

Znj. Aulona Bylykbashi: Jo nuk jemi në rrugën e të parit.

Kleo Sadiku

Amzo Ramxha

Dorvaldo Aleshi

Luis Alla

Ergys Musaj

Ilali [illegible]

Artan Kovaçi

Jamir Mezhaqi

Hektor Çillo

Geri Pëllombi

Enjo Nergjoni

Fabian Bujani

Orgito Sufoli

Ardjan Monaj

Mateo Gaçe

Sokol Sinani

Muharrem Doshi